

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE

NIPT L71710039A

Nr.1774 Regj  
Nr.2866 Prot

Tiranë, më 05.10.2021

URDHËR

“PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”

**Drejtuar:** Qendra Kombetare e Biznesit  
**Adresa:** Tirane  
**Drejtuar:** ZICO Sh.a me Nipt K61812006M  
**Adresa:** TIRANE VAQAR, (tregtim te vajrave dhe lubrifikante)Tel: 048520038  
(Tregti me pakice veshje konfeksione)Tel: 0682324872  
**Per dijeni:** Autoriteti Kombëtar i Ushqimit  
**Adresa:** Rr. “Myslym Keta”, Tiranë



Unë, Eris Sotiri, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Zyrës Përmbarimit Privat “REAL BAILIFF SERVICE” Sh.p.k, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Vendim Nr.493, datë 29.09.2020 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 1774, Datë 21.09.2021 kërkesën e kreditorit Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ndaj debitorit ZICO Sh.a me Nipt K61812006M në lidhje me titullin ekzekutiv, “Procesverbal Inspektimi dhe Vendimi Perfundimtar Nr. AKU-VL-2018-000491-1, datë 12.12.2018”

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr.2764 Prot, Datë 21.09.2021, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Vendimi Vendim Nr.493, datë 29.09.2020 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

**KONSTATOVA:**

ZICO Sh.a me Nipt K61812006M, nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të lajmërimit per ekzekutim vullnetar te detyrimit.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestro mbi kreditë e debitorit ZICO Sh.a me Nipt K61812006M në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të nenit 527 e vijues te K.Pr.Civile, si dhe të neneve 36 pika (e), 37 pikat (c) dhe 53 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit 26/2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”, me qellim ekzekutimin e titullit ekzekutiv,

**URDHËROJ:**

1. Qendra Kombetare e Biznesit, të vendose sekuestron konservative mbi aktivet e pales debitore **ZICO Sh.a me Nipt K61812006M me qellim mostjetersimin tyre, si dhe mos kryerjen e çdo veprimi pezullim apo cregjistrim qe do te sillte ndryshime ne regjistrin tregetar.**
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdheri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dijeni.

ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE  
PËRMBARUESI GJYQËSOR

ERIS SOTIRI